

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Ramiz Azizi, me zyrtaren ligjore Florentina Ademi, në lëndën penale ndaj të pandehurit V. C., nga fshati L. i U. komuna e Gj., për shkak të veprës penale Ngasje në gjendje të pa aftë apo të dehur, nga neni 379 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.2174/2015 të datës 10.12.2015, të cilin e përfaqësonte prokurori Shefik Mehmeti , pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 16.10.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri V. C. nga babai Rr. dhe nëna S., i lindur më ..., në fshatin L. i U. komuna e Gj., ku edhe tani jeton, ka të kryer ..., I martuar, baba ... fëmijëve, ... punë ,I gjendjes së . ekonomike, shqiptar,shtetas I Republikës së Kosovës.

Është fajtor

Sepse më datën 02.12.2015 rreth orës 20:00 minuta në Gjilan në rrugën “Bulevardi i Pavarësisë” ka rrezikuar trafikun publik duke vu në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, ashtu që kundërshtim të nenit 227 pika 5 të Ligjit për Sigurinë e Komunikacionit Rrugor të Republikës së Kosovës, në gjendje të dehur me 1.32 promila në gjak, ka drejtuar automjetin e tij të udhëtarëve të markës “...” me targa të regjistrimit ..., në rrugën “...” në drejtim të qendrës së qytetit dhe me të arritur përballë Teatrit të qytetit, me pjesën e parë të automjetit, e godet në pjesën anësore të parë të anës së djathtë, automjetin tjetër të udhëtarëve të markës “...”, me targa të regjistrimit ... të cilin e drejtonte P. H. nga Gj., i cili në momentin kritik ishte kyçur nga rruga e Prishtinës, në rrugën Bulevardi i Pavarësisë-rrugë kryesore me përparësi kalimi dhe nga ky aksident i shkaktuar i komunikacionit, dëme materiale pasojën që të dy automjetet, në këtë mënyrë i pandehuri duke e ngarë automjetin e tij në gjendje të pa aftë apo të dehur ka rrezikuar trafikun publik dhe vu në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre,

-me çka ka kryer veprën penale, Ngasje në gjendje të pa aftë apo të dehur, nga neni 379 paragrafi 1 të KPRK-së

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenet 4,7,17,21,23,49,50,51,52,62,68,73,74 të KPRK-së, si dhe të neneve 365,451 dhe 463 të KPPRK-së, atij i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

*Ashtu që të pandehurit V. C. i caktohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej **180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve**, të cilin dënim i pandehuri nuk do ta mbajë, nëse në afat prej **1 (një) viti e 6 (gjashtë) muajve** nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.*

*Po ashtu të njëjtit i shqiptohet edhe dënimi plotësues ndalimi i drejtimit të automjetit në kohëzgjatje prej nje viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i njëjti në afatin prej **1 viti (një) e 6 (gjashtë)muajve** pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër të ngjashme penale.*

I dëmtuari P. H., nga Gj. rruga”..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që t’i paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 20 €, në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shpenzimet e tjera të procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit V. C. nga Gj., për shkak të veprës penale Ngasje në gjendje të pa aftë apo të dehur, nga neni 379 paragrafi 1 të KPRK-së.

Në fillim të shqyrtimit fillestar, pas leximit të aktakuzës së lartcekur i pandehuri V. C., ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, duke theksuar e pranojë fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale e cila më vihet në barrë sipas kësaj aktakuze, duke shtuar se më vjen keq për rastin e ndodhur, ndërsa gjykatës i ka premtuar se në të ardhmen do të jetë shumë më i kujdesshëm gjatë drejtimit të automjetit.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas dëgjimit të Prokurorit të Shtetit konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajësisë, ngase i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri; pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për

plotësimin e aktakuzës të pranuar nga i pandehuri dhe çdo provë tjetër, si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike :

Se i pandehuri V. C., nga Gj., nga pakujdesia ka kryer veprën penale ngasje në gjendje të pa aftë apo të dehur, nga neni 379 paragrafi 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjyqtari i vetëm gjykues, ka konstatuar se në këtë çështje juridike penale duhet të aplikohet Kodi i ri Penal i Republikës së Kosovës dhe vepra penale duhet të kualifikohet sipas nenit 379 paragrafi 1 të këtij Kodi, ngase konsiderohet ligj më i favorshëm për të pandehurin se sa Kodi Penal i Kosovës, i vitit 2004, për faktin se për këtë formë të kësaj vepre penale ka parashikuar dënim më të butë.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të pandehurit V. C., gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 73 dhe 74 të KPRK, ku si rrethana lehtësuese, gjykata e ka marrë për bazë faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, sjelljen shumë të mirë të tij gjatë shqyrtimit fillestar, se i pandehuri ka shprehur keqardhje për rastin e ndodhur, se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale, si dhe faktin se i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm gjatë drejtimit të automjetit. Ndërsa, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, caktimi i dënimit me kusht, ndaj të pandehurit V. C., është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 50 të KPRK.

Vendimi mbi shqiptimin e dënimit plotësues është i bazuar në nenet 62 e 68 të KPRK-së.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike është marrë duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP, kurse vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 paragrafi 1 të KPP.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i përgjithshëm
Më 16.10.2017

*Zyrtarja Ligjore,
Florentina Ademi*

*Gjyqtari i vetëm gjykues,
Ramiz Azizi*

KËSHILLA JURIDIKE : *Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.*